



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



1-7 SHTATOR JAVA E MBROJTJES

PÛRKUJTOHET KRIJIMI I KOMANDËS SË FORCËS TOKËSORE

Në një ceremoni të veçantë, të zhvilluar në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore në Zall-Herr, u përkujtua krijimi i kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në fjalën e tij, ministri Vengu vlerësoi rëndësinë që ka pasur themelimi i Komandës së Forcës Tokësore si një akt i domosdoshëm për ringritjen e ushtrisë shqiptare. Për ministrin, modernizimi dhe fuqizimi i kapaciteteve ushtarake nuk përbëjnë luks, por një detyrë për të garantuar sigurinë dhe sovranitetin e vendit.

★★★★★



MIRËNJOHJE PËR TRUPAT E EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

Trupat nga Emiratet e Bashkuara Arabe kanë përfunduar misionin trejavor në Shqipëri në betejën kundër zjarreve. 72 efektivë dhe 2 helikopterë tip Black Haëk kryen dhjetëra operacione nga ajri dhe toka, duke asistuar forcat shqiptare në shuarjen e zjarreve. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, shprehu mirënjohjen për këtë kontribut të çmuar.

JM

★★★★★



DYFISHOHET NUMRI I APLIKANTËVE NË KURSIN E FORCAVE SPECIALE

Pas 6 muajsh stërvitje intensive, gjenerata e re e Forcave Speciale i është bashkuar Forcave të Armatosura. Këtë vit është shënuar dyfishim i numrit të aplikantëve krahasuar me vitin e kaluar, duke treguar rritjen e interesit të të rinjve për këtë njësi elitare.

JM





EFEKTIVËT E XHENIOS DHE FSK, TRAJNIM TË PËRBASHKËT

Efektivët e Togës së Urave në Batalionin e Xhenios, në bashkëpunim me kolegë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë duke zhvilluar trajnimin “Procedurat e montimit dhe çmontimit të urave Mabey & Johnson”. Përvetësimi i njohurive teorike dhe shkëmbimi i eksperiencave në lidhje me teknikat dhe procedurat e ndjekura për montimin e urave ishte qëllimi kryesor i këtij trajnimi.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

BMEC FESTON 38-VJETORIN E KRIJIMIT

Baza e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC) shënoi 38-vjetorin e krijimit të saj. Në ceremoninë e mbajtur me këtë rast, ministri Vengu theksoi se BMEC prej dekadash ka qenë në vijën e parë të përballjes me fatkeqësitë natyrore dhe situatat emergjente.

JM

★★★★★

mod.gov.al



SHQIPËRIA NË STËRVITJEN “EXERCISE OAK RESOLVE”

Efektivët e Kontingjentit të XVII, EOD janë bërë pjesë e stërvitjes ndërkombëtare “Exercise OAK Resolve”, ku kanë ofruar mbështetje për Brigadën Shumkombëshe Letoneze. Ata kanë kryer detyra reale për asgjësimin e mjeteve të pashpërthyera (UXO), si dhe hapjen e shtigjeve për të mundësuar lëvizshmërinë e trupave gjatë zhvillimit të operacioneve.

★★★★★

mod.gov.al

JM



KËMBËSORIA E JUGUT FITON KAMPIONATIN E FUTBOLLIT

Nga data 1 deri më 4 shtator, në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua kampionati i futbollit mes reparteve. Pas një gare sportive të ngjeshur, vendin e parë e siguroi Regjimenti i Këmbësisë së Jugut, duke u shpallur fitues i këtij edicioni.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RRITEN KËRKESAT PËR KURSIN E OFICERIT

Forcat e Armatosura po tërheqin gjithnjë e më shumë të rinj. Këtë vit janë regjistruar 127 kandidatë në Kursin e Përgatitjes së Oficerit, mes tyre 33 vajza dhe 94 djem. Kjo shënon një rritje prej 108% krahasuar me vitin e kaluar, duke treguar interesin dhe besimin në rritje për karrierën në Forcat e Armatosura.

JM



mod.gov.al